



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Ekonomi (2020/2021)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i tretë (doktoratë)
SETK	180
Kodi	N-PhDCO180C
Titulli	Doktor i shkencave ekonomike / Drejtimi: Ekonomi
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-3076/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	16.10.2020

Përshkrimi i programit

Qëllimet e programit janë:

- Ngritja e nivelit të administrimit dhe të udhëheqjes së ndërmarrjes dhe zhvillimi i menaxhmentit bashkëkohor;
- Aftësimi dhe ndërtimi i menaxherëve të profilit bashkëkohor: sipërmarrës, të gatshëm të ndërmarrin aksione, por edhe rreziqe të cilat ndërlidhen me çdo iniciativë, fleksibile, persona të vendosur dhe të guximshëm;
- Arsimimi i menaxherëve me kualifikim të lartë dhe profesionistë me aftësi lideri dhe dëshira për t'u ballafaquar me sfidat e mileniumit të ri;
- Krijimi i menaxherëve me pikëpamje të reja dhe mënyra të të menduarit, zhvillimi i aftësive për parashikimin e të ardhmes dhe pranimin e sfidave dhe mundësive, të cilat i ofron biznesi në shekullin 21.

Karriera

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

- Të punojnë në mënyrë individuale dhe në grupe në hulumtimin e formave më përkatëse për plotësimin e nevojave të popullatës,
- T'i elaborojnë dallimet dhe nevojat e bashkësisë, nga aspekti shkencor dhe profesional.
- Të marrin pjesë aktive në ndërtimin e politikës makroekonomike dhe mikroekonomike.
- Të jenë të informuar dhe të kontribuojnë në elaboratet shkencore dhe profesionale.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Llogaritja e agregateve themelore makroekonomike dhe analizë kritike e politikave aktuale makroekonomike.
- Dhënia e mendimit kritik për politikat zhvillimore dhe për aplikimin e tyre në ekonominë kombëtare.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për të diagnostifikuar zhvillimet aktuale të tregut, parashikim të tendencave të këtyre zhvillimeve dhe analiza e efekteve e masave të politikës ekonomike mbi lëvizjet e tregut.

Aftësitë për të vlerësuar

- Të jenë në gjendje të përfshihen në pozita udhëheqëse në organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse në vend dhe nëpër botë.
- Analiza e proceseve të përgjithshme të zhvillimit ekonomik në botë dhe veçanërisht në proceset e tranzicionit, rajonalizimit dhe globalizimit të trendeve botërore ekonomike.

Aftësitë e komunikimit

- Mundësia e zhvillimit të aftësive personale, komunikimit, hulumtimit dhe aftësi të tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për punësim.
- Mundësia që studentët në mënyrë aktive të angazhohen në ligjërata dhe të kryejnë hulumtime të pavarura në të gjitha fushat e biznesit dhe ekonomisë.

Aftësitë e të mësuarit

- Zhvillimi i konceptit i të menduarit kritik të studentëve.
- Mundësia e përvetësimit të aftësive hulumtuese dhe përvojës për menaxhim, marketing dhe financa publike, në organizatat private dhe jofitimprurëse.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [C2012] [10.0 SETK] **Metodologjia sasiore të hulumtimit**
- [C2013] [10.0 SETK] **Ekonomia dhe teoria e përgjithshme**
- [C2014] [10.0 SETK] **Ekonomia e sjelljes në mjedisin jetësor**

Semestri 2

- [DBE0105] [10.0 SETK] **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [PHD-S3-S4-01] [40.0 SETK] **Punë kërkimore-shkencore**
- [PHD-S3-S4-02] [15.0 SETK] **Publikime I**
- [C2016] [5.0 SETK] **Mobiliteti i studentëve**

Semestri 4

Semestri 5

- [DBE0104] [20.0 SETK] **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**
- [PHD-S5-01] [10.0 SETK] **Publikime II**

Semestri 6

- [EC-PhD-THESIS] [30.0 SETK] **Disertacioni i doktoratës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia sasiore të hulumtimit**

Kjo lëndë i njofton studentët me problemet në ekonometri, përfshirë edhe zgjedhjen e formave funksionale dhe specifike, preventivën prej keqpërdorimeve të supozimeve të modelit linear klasik, me elementet e gjasës dhe statistikave të ekonometrisë, intuitën dhe vlerësimin teorik të modeleve të regresionit, më një dhe më shumë ndryshime, realizimin e kërkimit origjinal empirik, modelin e përgjithshëm linear, strukturën e modelit dinamik dhe vlerësimin e ndryshimeve me ndërvarësi të kufizuar e tjera. Kjo lëndë, gjithashtu, është e dizajnuar për studentë të cilët përgatiten për të punuar projekttezen e doktoratës. Qëllimet kryesore të lëndës janë që studentëve t'u ofrohen vegla për konceptualizim të tezës së tyre në raport me gjetjen e çështjes së hulumtimit shkencor dhe krijimin e metodave për mbledhjen e të dhënave dhe për analizë cilësore. Lënda është e fokusuar në problemet e metodave dhe teknikave si bie fjala ç'është analiza statistikore, tekstet lidhur me teorinë dhe testimi i hipotezave. Pastaj me rëndësi janë edhe temat për inferencën deskriptive dhe kauzave, hulumtimet dhe studimet longitudinale, krahasimtare të rastiit. Informata progresive do te ofrohen për mbledhjen e të dhënave duke punuar me tekst. Qëllimi është analiza e të dhënave cilësore, vënia finale në funksion i të gjitha veprimeve teorike në funksion të dizajnit dhe shkrimit të tezës. Aspektet epistemologjike të lëndës do të materializohen përmes pyetjeve – se si i pranojmë ne? Çka është teoria e njohjes, çka është njohja, si mund të arrijmë te dituritë shkencore dhe te e vërteta?

- **Ekonomia dhe teoria e përgjithshme**

Objekti i kësaj lënde është njohja e studentëve me parimet e avancuara të ekonomisë, si dhe me çështjet e biznesit bashkëkohorë. Lënda do t'i ndihmojë studentët të përcaktojnë fushën e tyre të interesit kërkimor. Në mënyrë të veçantë, qëllimet e lëndës janë që t'u mundësojë studentëve: - të zhvillojnë dhe kuptojnë teorinë dhe konceptet e mikroekonomisë dhe makroekonomisë dhe zbatimin e tyre në botën reale; - të zhvillojnë vlerësim të ndikimit mbi individët dhe shoqëritë e ndërveprimeve ekonomike ndërmjet kombeve; - të zhvillojnë njohje për çështjet e zhvillimit me të cilat përballen kombet dhe si ato i nënshtrohen procesit të ndryshimit.

- **Ekonomia e sjelljes në mjedisin jetësor**

Lënda synon të ofrojë kuptimin e temave nga ekonomia e mjedisit dhe të burimeve nga një perspektivë e sjelljes ekonomike. Më në detaje, rezultatet e të nxënësve do të jenë: - Sfondi rreth ekonomisë së sjelljes, përparësitë përkatëse teorike, paragjykimet e sjelljes, metodat eksperimentale. - Përmbledhje e përgjithshme e "ekonomia e jo-sjelljes": mjetet ekzistuese të politikave, modelet teorike shkurtimisht. - Një kuptim i thelluar i përshtatjes dhe zbutjes së strategjive të paqartësisë nën lojërat e përdorimit të mirave publike, dobësitë dhe koordinimit e lojërave me të mirat publike. - Një kuptim i thellë i bashkëpunimit në lojërat (dinamike) të koordinimit, mekanizmat e ankandit, ofrimi i bisedës mjedisore me anë të pagesave për shërbimet e ekosistemit, subvencionet e përshtatjes së teknologjisë dhe roli i liderit. Fokusi do të jetë në instrumentet që mund të përdoren për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin. - Qasja e ekonomisë së sjelljes ndaj qëndrueshmërisë - Studentët do të fitojnë njohuri se si të lidhin ekonominë e sjelljes dhe ekonominë mjedisore. - Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe përshkruajnë literaturën përkatëse, d.m.th., studimet e ekonomisë mjedisore duke përdorur perspektivën e sjelljes.

- **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**

Pas semestrit të parë, studenti fillon aktivitetet e tij për përpilimin e planit mbi disertacionin e doktoratës. Aktivitetet përfshijnë: përcaktimin e literaturës, përcaktimin e kornizës hipotetike, përkufizimin e metodologjisë së punës, përcaktimin e planit individual dhe prezantimin e parë publik. Po të ketë nevojë mund të organizohen edhe lëndë zgjedhore për këtë qëllim.

- **Punë kërkimore-shkencore**

Në vitin e dytë (semestri 3 dhe 4) doktoranti e vazhdon aktivitetin kërkimor sipas planit të miratuar individual. Mentori jep vlerësimet në lidhje me këto aktivitete.

- **Publikime I**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore në përputhje me kriteret relevante të mediumit botues. Aktivitetet botuese, suksesi i kandidatit dhe rëndësia e fushës së kërkimit do të kontrollohet para audiencës shkencore.

- **Mobiliteti i studentëve**

Gjatë semestrit të katërt studenti është i detyruar të realizojë mobilitet në një institucion shkencor, ose institucion tjetër relevant për fushën e kërkimit jashtë vendit në një kohëzgjatje prej të paktën një javë. Qëllimi i mobilitetit të doktorantëve është të prezantojnë, shkëmbejnë dhe diskutojnë punën e tyre kërkimore me kolegë nga vende të tjera për të përmirësuar cilësinë e disertacionit të tyre. Për realizimin e mobilitetit studenti sjell dëshmi nga institucioni, të cilën ia dorëzon mentorit.

- **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**

Në fund të semestrit të pestë, pas aktiviteteve kërkimore në planin individual, doktoranti i prezanton publikisht rezultatet e përgjithshme të kësaj faze të tezës dhe kërkimit.

- **Publikime II**

Publikimi (botimi) i aktiviteteve kërkimore sipas kritereve të relevancës së mediumit botues. Aktivitetet botuese, suksesi i kandidatit dhe rëndësia e fushës së kërkimit do të kontrollohet para audiencës shkencore.

- **Disertacioni i doktoratës**

Vazhdimi i punës së disertacionit të doktoratës. Dorëzohet teza (disertacioni), pranohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, u dorëzohet anëtarëve të komisionit dhe fillon procedura e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **Ekonometria e avancuar**

Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me metodat bashkëkohore ekonometrike, dhe pranimin praktik të këtyre metodave duke shfrytëzuar, RATS dhe Matlab. Lënda do t'i përfshijë 4 pjesë: pjesa e parë i përfshin pyetjet e matematikës statistikore, si përfundimet statistikore dhe teorinë maksimale likelihood, pjesa e dytë i përfshin pyetjet në lidhje me modelet lineare si regresionin e thjeshtë linear dhe atë të shumëfishtë, autokorrelacion endogjen, ndryshueshmëri instrumentale, pjesa e tretë përfshin: modelet jo lineare, si metodat jo lineare të katrorëve të vegjël dhe metodën e përgjithshme, pjesa e katërt i përfshin seritë kohore, si procesin stacionar dhe procesin stokastik, ARIMA (p,d,q) modelin dhe modelin vektorial autoregresion (VAR).

- **Ekonomia monetare**

Përmbajtja e programit: - Teoria e formave kreditore dhe strukturat e normave kamatore - Instrumentet financiare dhe tregjet financiare - Krijimi i parave dhe ofertave e parave - Kërkesa për para dhe marrëdhëniet me sektorin real. - Analiza monetare dhe krijimi i politikave monetare, - Krijimi i parave dhe inflacioni, - Kursi devizor dhe ndikimi në ekonomi, - Sistemi monetar në Maqedoni dhe pranimi i modeleve monetare, - Poliitkat konvergjente monetare, - Marrëdhëniet ndërkombëtare monetare dhe ndikimi në ekonominë nacionale, - EMU, Unioni Monetar European – sfidat dhe perspektivat, - Sistemet monetare ndërkombëtare dhe institucionet – MMF, SB, EBRD, IFC etj.

- **Financat publike**

Përmbajtja e programit: - Thelbi dhe rëndësia e financave publike; - Aspektet ideologjike (teorike të financave publike); - “Madhësia “ e qeverisë në aspekt të financave publike; - Ekonomia e sektorit publik; - Funkzioni lokativ; - Funkzioni shpërndarës; - Rregullativat shtetërorë të sektorit publik; - Eksternalitet dhe llojet; - Analiza pozitive e financave publike; - Roli i teorisë; - Metodot e analizës empirike (intervista, eksperimente dhe studime ekonometrike); - Analiza normative e financave publike; - Ekonomia e mirëqenies; - Shkëmbimi në ekonominë tipike; - Ekonomia e prodhimit; - Të ardhurat publike dhe shpenzimet publike, aspektet krahasuese të sistemit tatimor, - Efektet tatimore në lidhje me: efektivitetin, shpërndarjen, stabilitetin dhe zhvillimin, interesat personale të shërbimit publik; - Varfëria, mbrojtja sociale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore - Rishpërndarja e të ardhurave publike; - Programet e sigurimit social; - Programet e mirëqenies; - Programet e kujdesit shëndetësor; - Programe të tjera publike të financuara nga të ardhurat publike; - Aspektet krahasuese, tendencat dhe problemet; - Analiza e rasteve në politikat e shpenzimeve publike: Arsimi, Shëndetësia, Mbrojtja sociale; - Metodot e matjes e kështu me radhë.

- **Ekonomia ndërkombëtare**

Ekonomia ndërkombëtare është një disiplinë shkencore që është në zgjerim të vazhdueshëm. Tregjet financiare sot janë në një kuptim të vërtetë global. Asnjë student që ka studiuar ekonominë dhe financat nuk mund të kuptojë plotësisht zhvillimet në ekonominë kombëtare dhe në ekonominë botërore pa njohuri adekuate të financave ndërkombëtare. Temat e mbuluara në këtë temë - çështja e bilancit-e-zërave bilancorë, përcaktuesit e kursit të këmbimit, faktorët të cilët qëndrojnë prapa flukseve ndërkombëtare të kapitalit, filozofia e punës e kompanive multinacionale dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, etj. - Nuk janë subjekt interesi vetëm për grupe të vogla të ekonomistëve akademikë ose profesionistë të specializuar.

- **Financat ndërkombëtare**

Financat ndërkombëtare është një disiplinë shkencore që është në zgjerim të vazhdueshëm. Tregjet financiare sot janë në një kuptim të vërtetë global. Asnjë student që ka studiuar ekonomi dhe financa nuk mund të kuptojnë

plotësisht zhvillimet në ekonomitë kombëtare dhe të ekonomisë botërore pa njohuri adekuate të financave ndërkombëtare. Temat e mbuluara në këtë temë - çështja e bilancit-e-zërave bilancorë, përcaktuesit e kursit të këmbimit, faktorët të cilët qëndrojnë prapa flukseve ndërkombëtare të kapitalit, filozofia e punës e kompanive multinacionale dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, etj. - Nuk janë subjekt interesi vetëm për grupe të vogla të ekonomistëve akademikë ose profesionistë të specializuar.

- **Ekonomia financiare**

Kjo lëndë synon zhvillimin e kompetencave të studentëve në drejtim të: - Vlerësimit të kontributit që japin teoritë e ndryshme ekonomike për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. - Shfrytëzimit të investimeve, portofolit, dhe teorive të financave të korporatës - Përcaktimit të ndikimit të tregjeve financiare në ekonomi. - Kuptimit edhe praktikisht aplikimit praktik të teknikave për vlerësimin e asetëve - Vlerësimit të strukturës së kapitalit, kostove të financimit dhe shfrytëzimit të metodave të ndryshme të buxhetimit. - Aplikimit dhe vlerësimit kritik të tregut të kapitalit përmes modeleve financiare. - Kuptimit të efekteve që kanë krizat ekonomike në tregun real dhe kuptimit të klimës makroekonomike.